



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTARSTVO OBRAZOVANJE I NAUKE  
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE

**INSTITUTI  
PEDAGOGJIK  
I KOSOVËS**

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS  
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA  
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

## THIRRJE PUBLIKE

### **Për angazhimin e dy bashkëpunëtorëve të jashtëm për finalizimin e Udhëzuesit dhe të Programit të trajnimit për mësimdhënës**

Në mbështetje të Nenit 10, pika 2 të *Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës*, vendimit të Këshillit Drejtues me nr.prot.45/26, të datës 01.07.2026, si dhe në përmbushje të Planit Zyrtar të Punës për vitin 2026 (konkretisht pika 4 “Aktivitetet mbështetëse profesionale për DKA dhe shkolla”), Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) shpall këtë thirrje publike për angazhimin e dy bashkëpunëtorëve të jashtëm (ekspertëve) për finalizimin e Udhëzuesit dhe Programit të trajnimit për mësimdhënës.

#### **Qëllimi i angazhimit:**

Qëllimi i këtij angazhimi është rishikimi, harmonizimi dhe finalizimi profesional e përmbajtësor i udhëzuesit për mësimdhënës dhe i moduleve të trajnimit. Synohet krijimi i një pakoje të integruar, koherente dhe të strukturuar sipas standardeve bashkëkohore (qasjet e bazuara në kompetenca dhe perspektivat sipas praktikave më të mira vendore e ndërkombëtare), e cila do të jetë e gatshme për zbatim të menjëhershëm në praktikë.

Draftet e dy dokumenteve që do të finalizohen janë:

1. **Udhëzuesi për mësimdhënës, me temë** “Lexim-kuptimi, lexim-shkrimi dhe zhvillimi i mendimit kritik e kreativ”;
2. **Programi i trajnimit (me tri module):** Lexim-kuptimi, Lexim-shkrimi, dhe Zhvillimi i mendimit kritik e kreativ te nxënësit.

Për të arritur këtë qëllim, IPK-ja do të angazhojë dy bashkëpunëtorë të jashtëm (ekspertë) për pozitat e mëposhtme.

## **POZITA 1: Bashkëpunëtor i jashtëm (ekspert) nga Fusha e Shkencave të Natyrës**

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike:

- Të analizojë në detaje përmbajtjen e draftit të udhëzuesit ekzistues dhe të tri moduleve të programit të trajnimit nga perspektiva e Shkencave të Natyrës;
- Të bëjë harmonizimin e plotë ndërmjet dy dokumenteve për të siguruar koherencë metodologjike, shkencore dhe tematike;
- Të pasurojë udhëzuesin dhe modulet me shembuj praktikë, eksperimente, aktivitete konkrete dhe ushtrime të zbatueshme në klasë për lëndët e shkencave të natyrës;
- Të rishikojë dhe përmirësojë strukturën, objektivat specifike dhe rezultatet e të nxënit;
- Të sigurojë përputhshmërinë e plotë të moduleve me Kurrikulën e Kosovës dhe standardet bashkëkohore të mësimdhënies;
- Të dorëzojë versionin përfundimtar, të redaktuar profesionalisht dhe të gatshëm për aprovim në Këshillin Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM).

### **Kriteret e kualifikimit për pozitën 1:**

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- Të ketë të përfunduara studimet e doktoratës (PhD) në fushën e shkencave të natyrës ose fusha të ngjashme relevante (doktorata do të konsiderohet përparësi, por nuk është kusht eliminuese për kandidatët që dëshmojnë ekspertizë dhe përvojë e konsiderueshme profesionale në fushën përkatëse);
- Të ketë përvojë të dëshmuar profesionale në hartimin, zhvillimin ose rishikimin e udhëzuesve, kurrikulave, moduleve, apo programeve të trajnimit për mësimdhënës.
- Të ketë njohuri të avancuara në fushën e leximit, shkrimit, mendimit kritik dhe kreativ, të ndërlidhura me shkencat e natyrës.
- Të ketë aftësi të dëshmuara në redaktim, strukturim dhe zhvillim të materialeve didaktike.

Përvoja në projekte të ngjashme do të konsiderohet përparësi.

## **POZITA 2: Bashkëpunëtor i jashtëm (ekspert) për IT dhe digjitalizim të përmbajtjeve mësimore**

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike:

- Të analizojë draftin e udhëzuesit dhe tri modulet ekzistuese, me qëllim të integrimin të teknologjisë dhe të digjitalizimit;
- Të rishikojë dhe të përfshijë metodologjitë e mjetet bashkëkohore të IT-së (e-learning, platformat digjitalizuese, aplikacionet arsimore) brenda paketës së trajnimit;
- Të pasurojë modulet me shembuj praktikë dhe ushtrime, se si lexim-kuptimi, lexim-shkrimi dhe mendimi kritik e kreativ mund të zhvillohen përmes mjeteve digjitale të nxënësit;
- Të sigurojë që udhëzuesi dhe programi i trajnimit të jenë në harmonizim me standardet e kompetencës digjitale, sipas Kurrikulës së Kosovës;
- Të dorëzojë sugjerimet dhe modelin e digjitalizuar të materialeve mbështetëse për trajnim.

### **Kriteret e kualifikimit për pozitën 2:**

- Të ketë të përfunduara studimet e doktoratës (PhD) në fushën e Teknologjisë së Informacionit (IT), Shkencave Kompjuterike, Teknologjisë në Edukim, ose fusha të ngjashme relevante. (Doktorata konsiderohet përparësi, por nuk është kusht eliminues për kandidatët me përvojë të konsiderueshme profesionale);
- Të ketë përvojë e dëshmuar profesionale në digjitalizimin e përmbajtjeve mësimore, të materialeve didaktike ose platformave trajnuese;
- Të ketë përvojë të dëshmuar profesionale në hartimin, zhvillimin ose rishikimin e udhëzuesve, të kurrikulave, të moduleve apo programeve të trajnimit për mësimdhënës;
- Të ketë njohuri mbi integrimin e mendimit kritik, kreativ dhe shkathësive të lexim-shkrimit përmes teknologjisë;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në strukturimin dhe zhvillimin e materialeve mësimore digjitale/interaktive.

Përvoja në projekte të ngjashme do të konsiderohet përparësi.

**Kohëzgjatja e angazhimit dhe produktet e pritshme:**

Angazhimi për secilin ekspert do të jetë 10 ditë pune.

I gjithë procesi dhe realizimi dhe dorëzimi i punës duhet të bëhet deri më 15.08.2026.

Në përfundim të angazhimit, ekspertët në bashkëpunim duhet të dorëzojnë versionin final të udhëzuesit dhe tri moduleve të harmonizuara, të redaktuara dhe të pasuruara me materiale mbështetëse, në përputhje me kërkesat e Institutit Pedagogjik të Kosovës.

**Procedura e vlerësimit dhe parimi i meritokracisë:**

Përzgjedhja do të bazohet në parimin e meritës, duke marrë parasysh kualifikimet akademike, përvojën profesionale, ekspertizën specifike dhe relevancën e tyre për detyrat e angazhimit. Institucioni rezervon të drejtën të përzgjedhë kandidatin që vlerësohet më i përshtatshmi për realizimin e detyrës, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të aplikimit dhe dëshmitë e ekspertizës profesionale.

**Konflikti i interesit:**

Kandidatët janë të obliguar të deklarojnë çdo rrethanë që mund të paraqesë konflikt interesi në raport me këtë angazhim.

**Vlerësimi i aplikimeve:**

Aplikimet do të vlerësohen nga komisioni i emëruar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, bazuar në kualifikimet akademike, përvojën profesionale, ekspertizën relevante dhe dëshmitë e angazhimeve të mëparshme në fusha të ngjashme.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim****Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:**

CV-në e përditësuar;

Letrë motivuese;

Dëshmitë për kualifikimet akademike;

Referencat ose dëshminë për përvojën relevante profesionale (përfshirë dëshmitë për projekte IT/digjitalizim apo shkencat e natyrës);

Listën e publikimeve dhe/ose projekteve relevante (nëse ka).

### **Mënyra e aplikimit**

Dokumentet e aplikimit duhet të dërgohen në adresën elektronike: [institutipedagogjik@gmail.com](mailto:institutipedagogjik@gmail.com), me **subjekt**: Aplikim për bashkëpunëtor të jashtëm 1 ose Aplikim për bashkëpunëtor të jashtëm 2, për finalizimin e udhëzuesit dhe të moduleve të trajnimit.

### **Afati për aplikim**

Afati i fundit për aplikim është 15.07.2026 deri në orën 16:00

Instituti Pedagogjik i Kosovës inkurajon të gjithë bashkëpunëtorët e jashtëm (ekspertët), të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara, të aplikojnë për këtë angazhim.